



Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“RIPARIME TË PAJISJEVE ELEKTROSHTËPIAKE”

Niveli III në KSHK¹, referuar nivelit III të KEK²

K-E3-III-23

Tiranë, 2023

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Përmbajtja

Emërtimi i kualifikimit.....	4
Kodi.....	4
Kohëzgjatja	4
Niveli.....	4
Qëllimi:	4
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	4
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:.....	4
Ofruesit.....	4
Data e validimit	4
Data e miratimit.....	4
Variantet e mëparshme.....	4
STRUKTURA E KUALIFIKIMIT	5
Kompetenca të përgjithshme	5
NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:	5
E3-05-III-0031-24 Planifikimi dhe organizimi i punës në riparim pajisjesh elektroshtëpiake ..	5
Rezultatet e të nxënit në njohuri.....	5
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale.....	6
Kriteret e vlerësimit.....	6
E3-05-III-0032-24 Ndërtimi dhe funksioni i pajisjeve elektroshtëpiake	6
Rezultatet e të nxënit në njohuri.....	7
Kriteret e vlerësimit.....	7
E3-05-III-0033-24 Makina dhe transmise elektrike.....	7
Rezultatet e të nxënit në njohuri.....	7
Kriteret e vlerësimit.....	7
E3-05-III-0034-24 Elektronikë e zbatuar	8
Rezultatet e të nxënit në njohuri.....	8
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale.....	8
Kriteret e vlerësimit.....	8
E3-05-III-0035-24 Diagnostikimi i defekteve	8
Rezultatet e të nxënit në njohuri.....	8
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale.....	9
Kriteret e vlerësimit.....	9
E3-05-III-0036-24 Riparime dhe zëvendësime në pajisje elektroshtëpiake	9
Rezultatet e të nxënit në njohuri.....	9
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale.....	10
Kriteret e vlerësimit.....	10
E3-05-III-0037-24 Mirëmbajtja e pajisjeve elektroshtëpiake	11
Rezultatet e të nxënit në njohuri.....	11
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale.....	11
Kriteret e vlerësimit.....	11
E3-32-III-0013-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere	12
Rezultatet e të nxënit në njohuri.....	12
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale.....	12
Kriteret e vlerësimit.....	13
E3-31-III-0014-24 Komunikimi dhe etika profesionale	13
Rezultatet e të nxënit në njohuri.....	13
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale.....	14
Kriteret e vlerësimit.....	14
E3-05-III-0038-24 Sigurimi teknik dhe mbrojtja e mjedisit	14
Rezultatet e të nxënit në njohuri.....	14
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale.....	15
Kriteret e vlerësimit.....	15

Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:	15
Modalitetet e vlerësimit.....	16
Informacion shtesë	16
SHËNIM	17

Emërtimi i kualifikimit	“Riparime të pajisjeve elektroshtëpiake”			Kodi K-E3-III-23
Kohëzgjatja	900-1100 orë ³	Niveli	III në KSHK, referuar nivelit III të KEK	
Qëllimi:	Qëllimi i kualifikimit profesional “Riparime të pajisjeve elektroshtëpiake” niveli III-të në KSHK, referuar nivelit III të KEK, është të përgatisë punonjës të kualifikuar për kryerjen e riparimeve të pajisjeve elektroshtëpiake, për krijimin e një biznesi privat, si dhe të zhvillojë personalitetin e individit për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet e arsimit dhe formimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional “Riparim i pajisjeve elektroshtëpiake të niveli III-të në KSHK, referuar nivelit III të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> – kanë mbaruar dy vitet e para të shkollës së mesme në Kualifikimin “Elektroteknikë” niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK – janë në gjendje shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. <p>Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë institucioni përgjegjës përgatit udhëzime të veçanta me kriteret e posaçme pranimit për këto shkolla.</p>			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Riparim i pajisjeve elektroshtëpiake” niveli III-të në KSHK, referuar nivelit III të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale të nivelit dhe Suplementin përkatës të punonjësit të kualifikuar në këtë fushë. Ky kualifikim i jep individit mundësinë që t’i drejtohet tregut të punës për punësim në ndërmarrje që ofrojnë riparime dhe shërbime për pajisjet elektroshtëpiake, në njësitë që montojnë apo shesin pajisje elektroshtëpiake. Gjithashtu, individit mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e shitjes dhe riparimit të pajisjeve elektroshtëpiake.</p> <p>Me përfundimin e kualifikimit profesional “Riparim i pajisjeve elektroshtëpiake” niveli III-të në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individit ka të drejtë të vazhdojë arsimimin në nivelin teknik/menaxher. Me arsimim të mëtejshëm (niveli IV-të në KSHK, referuar nivelit IV të KEK) fiton të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p>			
Ofruesit	Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.			
Data e validimit	Korrik 2024			
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	E-II-03-12; E3-III-19			

³ Orë mësimore 45 minuta

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Në përfundim të kualifikimit profesional në “Riparim pajisjesh elektroshtëpiake”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

Kompetenca të përgjithshme

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënit.

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
2. Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
3. Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficientë.
4. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
5. Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
6. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
7. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
8. Të organizojë drejt, procesin e të nxënit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
9. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
10. Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij. për të nxënë gjatë gjithë jetës.

NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:

Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxënit (kompetenca të përgjithshme, njohuri dhe shprehje profesionale).

E3-05-III-0031-24 Planifikimi dhe organizimi i punës në riparim pajisjesh elektroshtëpiake

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë rëndësinë e planifikimit për realizimin e detyrës së dhënë;
2. Të shpjegojë rëndësinë e vendosjes së prioriteteve në proceset e punës;
3. Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit të burimeve njerëzore;
4. Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit të mjeteve, materialeve, pajisjeve të punës dhe instrumenteve matës;
5. Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit të kohës për kryerje e shërbimeve dhe riparimeve;
6. Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit, përzgjedhjes të pjesëve të këmbimit sipas standardit, si dhe mënyrës së blerjeve të tyre;
7. Të shpjegojë rëndësinë e organizimit të punës dhe të vendit të punës për procese të ndryshme pune;
8. Të listojë veglat, pajisjet dhe materialet e punës për procese të ndryshme pune të riparimit të pajisjeve elektroshtëpiake;

9. Të përshkruajë funksionin dhe përdorimin e aparateve matëse për diagnostikimin, riparimin dhe montimin e pajisjeve elektroshtëpiake,;
10. Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të funksionalitetit të mjeteve dhe veglave të punës para përdorimit;
11. Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrën e plotësimit të një urdhri pune sipas procesit të punës;
12. Të shpjegojë rëndësinë e mirëmbajtjes së veglave të punës gjatë kohëzgjatjes së punimeve dhe në përfundim të tyre;
13. Të shpjegojë mënyrën e kontrollit të pastrimit, sistemimit dhe mirëmbajtjes së vendit të punës;
14. Të listojë llojet e raportimeve dhe rëndësinë e respektimit të hierarkisë në vendin e punës;
15. Të shpjegojë rëndësinë e plotësimit të dokumentacionit teknik të nevojshëm;

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të menaxhojë burimet e nevojshme për kryerjen e riparimeve të pajisjeve elektroshtëpiake;
2. Të organizojë punën për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve elektroshtëpiake;
3. Të hartojë dhe menaxhojë dokumentacionin teknik;

Kriteret e vlerësimit

- Planifikon burimet e nevojshme njerëzore, sipas proceseve të punës;
- Përzgjedh burimet e nevojshme njerëzore, sipas proceseve të punës dhe kualifikimeve përkatëse;
- Planifikon mjetet, materialet, pajisjet e punës, sipas proceseve të punës dhe llojit të pajisjes elektroshtëpiake;
- Përzgjedh dhe përdor aparatet matëse dhe kontrolluese për diagnostikimin e defekteve, sipas llojit të pajisjeve elektroshtëpiake;
- Kontrollon funksionalitetin e mjeteve dhe pajisjeve të punës para përdorimit, sipas manualit;
- Përzgjedh mjetet, materialet, pajisjet e punës, sipas proceseve të punës dhe llojit të pajisjes elektroshtëpiake;
- Përzgjedh pjesët e këmbimit, sipas standardit dhe llojit të pajisjes elektroshtëpiake;
- Mirëmban mjetet dhe pajisjet e punës gjatë kohëzgjatjes së punimeve dhe në përfundim të tyre, sipas manualit
- Përcakton proceset e punës, sipas prioritetit;
- Planifikon hapat e punës për realizimin e detyrës së dhënë, sipas proceseve;
- Organizon punën, sipas proceseve;
- Organizon vendin e punës, sipas proceseve;
- Planifikon kohën për kryerje e proceseve sipas llojit të shërbimit;
- Kontrollon kryerjen e pastrimit, sistemimit dhe mirëmbajtjes së vendit të punës, sipas rregullores;
- Plotëson urdhrin e punës sipas procesit të punës;
- Plotëson dokumentacionin teknik të nevojshëm, sipas procesit;
- Raporton për punën e kryer, sipas hierarkisë;

E3-05-III-0032-24 Ndërtimi dhe funksioni i pajisjeve elektroshtëpiake

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e sobës elektrike;
2. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e mikrovalës;
3. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e shtrydhësit të frutave, mikserit;
4. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e fshesës me korrent dhe aspiratorit;
5. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e ekspresit të kafesë;
6. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e makinës larëse të rrobave;
7. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e makinës tharëse të rrobave;
8. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e makinën larëse të enëve;
9. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e frigoriferit;
10. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e hekurit profesional;
11. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e kondicionerit;

Kriteret e vlerësimit

- Shpjegon ndërtimin dhe funksionimin e sobës elektrike, sipas tipeve;
- Shpjegon ndërtimin dhe funksionimin e mikrovalës;
- Shpjegon ndërtimin dhe funksionimin e shtrydhësit të frutave, mikserit;
- Shpjegon ndërtimin dhe funksionimin e fshesës me korrent dhe aspiratorit;
- Shpjegon ndërtimin dhe funksionimin e ekspresit të kafesë;
- Shpjegon ndërtimin dhe funksionimin e makinës larëse të rrobave;
- Shpjegon ndërtimin dhe funksionimin e makinës tharëse të rrobave;
- Shpjegon ndërtimin dhe funksionimin e makinën larëse të enëve;
- Shpjegon ndërtimin dhe funksionimin e frigoriferit;
- Shpjegon ndërtimin dhe funksionimin e hekurit profesional;
- Shpjegon ndërtimin dhe funksionimin e kondicionerit;

E3-05-III-0033-24 Makina dhe transmise elektrike

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë veçoritë e makinave elektrike të tipeve të ndryshëm;
2. Të analizojë vetitë elektromekanike të tipeve të ndryshme të motorëve elektrikë;
3. Të interpretojë karakteristikat mekanike dhe të lexojë targetat e tipeve të ndryshme të motorëve elektrikë;
4. Të rendisë tipet dhe veçoritë e pajisjeve komutuese;
5. Të interpretojë skema të ndryshme të komandimi të pajisjeve elektrike;
6. Të shpjegojë parimet e transmiseve të thjeshta elektrike të pajisjeve elektroshtëpiake;

Kriteret e vlerësimit

- Analizon parimet e punës së makinave elektrike, sipas tipeve;
- Analizon skema të ndryshme të komandimi, sipas pajisjeve elektrike;
- Zgjedh tipin e motorit, sipas procesit dhe fuqisë së kërkuar;
- Zgjedh sensorët, sipas veçorive të pajisjeve;
- Zgjedh elementet mbrojtëse dhe komutuese, sipas pajisjes;
- Analizon parimet e transmiseve të thjeshta elektrike, sipas pajisjes elektroshtëpiake;

E3-05-III-0034-24 Elektronikë e zbatuar

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë parimin e punës të përforcuesve të tipeve të ndryshme;
2. Të shpjegojë rëndësinë e përzgjedhjes së përforcuesit në bazë të skemës;
3. Të listojë veçoritë e secilit përforcues;
4. Të shpjegojë parimin dhe kushtet e gjenerimit të sinjalit;
5. Të shpjegojë ndërtimin e një pakete elektronike;
6. Të shpjegojë matjet që kryhen në një paketë elektronike;
7. Të shpjegojë funksionimin e portave të thjeshta logjike;
8. Të interpretojë skemat e drejtuesve elektronikë industrialë;
9. Të shpjegojë rolin e burimeve të ushqimit AC/DC dhe DC/AC në qarqet elektrike;
10. Të analizojë skema të ndryshme ushqyesish;

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të analizojë aplikime të elektronikës në pajisje elektroshtëpiake;
2. Të montojë elemente dhe blloqe elektronike në pajisje elektroshtëpiake;

Kriteret e vlerësimit

- Analizon skemën e pajisjes elektroshtëpiake, sipas manualit përkatës;
- Analizon blloqet ndryshme të skemës, sipas parimit të bllokut;
- Përzgjedh paketën elektronike, sipas skemës dhe specifikimeve teknike;
- Monton një paketë elektronike, sipas manualit të pajisjes elektroshtëpiake;
- Kryen matjet e duhura në një paketë elektronike me instrumentet përkatës, sipas protokollit;
- Analizon burimet e ushqimit AC/DC dhe DC/AC në qarqet elektrike, sipas llojit të pajisjes elektroshtëpiake;
- Përzgjedh burimet e ushqimit AC/DC dhe DC/AC në qarqet elektrike, sipas llojit të pajisjes elektroshtëpiake;
- Monton burimet e ushqimit AC/DC dhe DC/AC në qarqet elektrike, sipas manualit;

E3-05-III-0035-24 Diagnostikimi i defekteve

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e informimit nga klienti për përcaktimin e defektet;
2. Të shpjegojë rëndësinë e leximit të manualeve të përdorimit, riparimit, mirëmbajtjes montimit dhe skemave të pajisjeve elektroshtëpiake;
3. Të shpjegojë rëndësinë zbatimit të protokolleve të sigurisë;
4. Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit vizual të pajisjeve me defekt;
5. Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të pjesëve mekanikë të pajisjeve me defekt;
6. Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të tubave të qarkullimit të gazit dhe ujit;
7. Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të furnizimit me energji elektrike të pajisjeve;
8. Të shpjegojë llojet e matjeve dhe kontrolleve të parametrave nominale elektrike;
9. Të argumentojë ndryshimet e rezultateve të matjeve të kryera nga parametrat nominale të dhëna në manualët përkatës;
10. Të shpjegojë rëndësinë e lokalizimit të defekteve;
11. Të shpjegojë mënyrat e riparimit të defekteve;

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë procedurat për diagnostikimin e defekteve në pajisjet elektroshtëpiake;

Kriteret e vlerësimit

- Merr informacion të plotë nga klienti në lidhje me problemin ose defektin;
- Lexon saktë manualin e përdorimit, riparimit, mirëmbajtjes, montimit dhe skemave të pajisjeve elektroshtëpiake;
- Identifikon dhe interpreton simbolet ose kodet e defekteve, sipas manualit;
- Zbaton protokollet e sigurisë, sipas rregulloreve përkatëse;
- Kryen kontrollin vizual të pajisjes elektroshtëpiake, sipas manualit;
- Kryen kontrollin e parametrave nominale elektrikë, sipas teknikave përkatëse;
- Kryen kontrollin e furnizimit me energji elektrike, duke përdorur aparatet përkatëse;
- Kryen kontrollin e lëvizjeve mekanike të pajisjes elektroshtëpiake, sipas funksionit;
- Kryen kontrollin e regjimit të temperaturës së pajisjes, sipas manualit përkatës;
- Kontrollon tubacionet e qarkullimit të gazit dhe ujit, sipas procedurës;
- Krahason rezultatet e matjeve të kryera nga parametrat nominale të dhëna në manualin përkatës;
- Lokalizon defektet në pajisjet elektroshtëpiake, sipas rastit;
- Përcakton mënyrën dhe vendin e riparimit të defekteve, sipas llojit të defektit dhe pajisjes;

E3-05-III-0036-24 Riparime dhe zëvendësime në pajisje elektroshtëpiake

Rezultatet e të nxënit në njohuri

- 1 Të listojë mjetet dhe pajisjet e punës për kryerjen e riparimeve ose zëvendësimeve në pajisjet elektroshtëpiake;
- 2 Të shpjegojë mënyrat dhe teknikat e riparimit/zëvendësimit të pjesës së dëmtuar në pajisje;
- 3 Të përshkruajë llojet e komponentëve elektrik dhe elektronik të pajisjes, sipas karakteristikave dhe funksioneve që ka secili prej tyre;
- 4 Të përshkruajë llojet e komponentëve mekanik të pajisjes, sipas karakteristikave dhe funksioneve që ka secili prej tyre;
- 5 Të shpjegojë procedurën dhe radhën e punës së çmontimit/montimit të pajisjes;
- 6 Të listojë mjetet dhe pajisjet e punës për kryerjen e proceseve të çmontimit, riparimit ose zëvendësimit dhe montimit të pajisjes elektroshtëpiake;
- 7 Të përshkruajë procesin e riparimit dhe/ose zëvendësimit të pjesëve të dëmtuara të pajisjes, duke u nisur nga skema teknike apo udhëzimet e prodhuesit;
- 8 Të listojë defektet kryesore të sobës elektrike, mënyrën e riparimeve të tyre;
- 9 Të listojë defektet kryesore të mikrovalës, mënyrën e riparimeve të tyre;
- 10 Të listojë defektet kryesore të shtrydhësit të frutave mikserit, mënyrën e riparimeve të tyre;
- 11 Të listojë defektet kryesore të fshesës me korrent dhe aspiratorin, mënyrën e riparimeve të tyre;
- 12 Të listojë defektet kryesore të ekspresit e kafesë, mënyrën e riparimeve të tyre;
- 13 Të listojë defektet kryesore të makinës larëse të rrobave, mënyrën e riparimeve të tyre;
- 14 Të listojë defektet kryesore të makinës tharëse të rrobave, mënyrën e riparimeve të tyre;

- 15 Të listojë defektet kryesore të makinën larëse të enëve, mënyrën e riparimeve të tyre;
- 16 Të listojë defektet kryesore të frigoriferit shtëpiak, mënyrën e riparimeve të tyre;
- 17 Të listojë defektet kryesore të hekurin profesional, mënyrën e riparimeve të tyre;
- 18 Të listojë defektet kryesore të kondicionerit, mënyrën e riparimeve të tyre;
- 19 Të shpjegojë teknikat dhe rëndësinë e regjistrimeve dhe shtrëngimeve sipas llojit të pajisjes elektroshtëpiake;
- 20 Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e rivendosjes së parametrave nominale të pajisjes pas kryerjes së riparimeve ose zëvendësimeve në të;
- 21 Të shpjegojë mënyrat e testimit dhe funksionalitetit të pajisjes së riparuar sipas standardit përkatës;

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kryejë riparime të defekteve në pajisje elektroshtëpiake;
2. Të kryejë zëvendësime të pjesëve/komponentëve të dëmtuar në pajisje elektroshtëpiake;
3. Të kryejë provën për funksionalitetin e pajisjes së riparuar;

Kriteret e vlerësimit

- Përzgjedh llojet e komponentëve elektrik dhe elektronik të pajisjes, sipas karakteristikave dhe funksioneve;
- Përzgjedh llojet e komponentëve mekanik të pajisjes, sipas karakteristikave dhe funksioneve;
- Zbaton radhën e punës së çmontimit/montimit të pajisjes, sipas procedurës;
- Riparon defektet kryesore të sobës elektrike, sipas procedurës;
- Riparon defektet kryesore të mikrovalës, sipas procedurës;
- Riparon defektet kryesore të shtrydhësit të frutave dhe mikserit sipas procedurës;
- Riparon defektet kryesore të fshesës me korrent dhe aspiratorin sipas procedurës;
- Riparon defektet kryesore të ekspresit e kafesë sipas procedurës;
- Riparon defektet kryesore të makinës larëse të rrobave sipas procedurës;
- Riparon defektet kryesore të makinës tharëse të rrobave sipas procedurës;
- Riparon defektet kryesore të makinën larëse të enëve sipas procedurës;
- Riparon defektet kryesore të frigoriferit sipas procedurës;
- Riparon defektet kryesore të hekurit profesional sipas procedurës;
- Riparon defektet kryesore të kondicionerit sipas procedurës;
- Zëvendëson përcjellësit e dëmtuar, sipas manualit të pajisjes;
- Zëvendëson bllokun e kontakteve ose morseteritë, sipas manualit përkatës.
- Zëvendëson siguresat, çelësat, kontaktorët etj. sipas manualit përkatës.
- Zëvendëson reostatët dhe rezistencat, sipas manualit përkatës.
- Zëvendëson programatorët, sipas manualit përkatës.
- Zëvendëson paketat elektronike, sipas manualit përkatës.
- Zëvendëson elementët rrotullues, sipas manualit përkatës.
- Zëvendëson elementët transmetues, sipas manualit përkatës.
- Zëvendëson linjat dhe pajisjet e furnizim-shkarkimit të ujit dhe gazit, sipas manualit përkatës.
- Zëvendëson matësit, rregullatorët dhe ekzekutuesit e temperaturës, sipas manualit përkatës;
- Zëvendëson motorët e pajisjeve elektroshtëpiake të tipeve të ndryshëm sipas manualit

- përkatës;
- Kryen regjistrime dhe shtrëngime në pajisjet elektroshtëpiake, sipas teknikave përkatëse;
- Rivendos parametrat nominal të pajisjes pas kryerjes së riparimeve ose zëvendësimeve, sipas manualeve;
- Kontrollon stabilitetin, vibrimet, akustikën etj. duke përdorur pajisjet përkatëse;
- Kryen provën për funksionalitetin e pajisjes së riparuar, sipas manualit përkatës;

E3-05-III-0037-24 Mirëmbajtja e pajisjeve elektroshtëpiake

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të listojë llojet e mirëmbajtjeve të pajisjeve elektroshtëpiake;
2. Të shpjegojë peshën/qëllimin e mirëmbajtjeve periodike, sipas kalendarit të shërbimeve, në jetëgjatësinë e pajisjeve elektroshtëpiake;
3. Të listojë mjetet dhe materialet për shërbimin e pastrimit të pajisjeve elektroshtëpiake
4. Të përshkruajë mënyrat e pastrimit në funksion të mirëmbajtjes në pajisjet elektroshtëpiake;
5. Të shpjegojë mënyrat e mirëmbajtjes së rrugëve të gazit, ajrit dhe ujit në pajisjet elektroshtëpiake;
6. Të shpjegojë mënyrat e pastrimit dhe mirëmbajtjes së kontakteve të elementeve komutues;
7. Të shpjegojë mënyrat e mirëmbajtjes së pjesëve mekanike të lëvizshme;
8. Të shpjegojë rëndësinë e regjistrimit dhe të shtrëngimeve të elementeve
9. Të rendisë llojet e materialeve për mirëmbajtje, funksionin dhe përdorimin e tyre;
10. Të theksojë rëndësinë e dokumentimit të mirëmbajtjeve në librin e shërbimeve sipas rregullores së brendshme;
11. Të përshkruajë mënyrën e mirëmbajtjes së kondicionerit, makinës larëse të rrobave, lavastoviljes etj;

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kryejë mirëmbajtjen e pajisjeve elektroshtëpiake;
2. Të kryejë provën për funksionalitetin e pajisjes elektroshtëpiake pas procesit të mirëmbajtjes;
3. Të dokumentojë procesin e mirëmbajtjes;

Kriteret e vlerësimit

- Kryen çmontimin e pjesshëm të pajisjes sipas procedurës përkatëse;
- Kryen saktë pastrimin e elementëve sipas manualit përkatës;
- Kryen mirëmbajtjen e rrugëve të ajrit në përputhje me manualin përkatës;
- Kryen mirëmbajtjen e rrugëve të gazit në përputhje me manualin përkatës;
- Kryen mirëmbajtjen e rrugëve të ujit në përputhje me manualin përkatës;
- Mat parametrat nominalë të pajisjes në përputhje me regjimin e punës;
- Kryen kontrollin e parametrave termikë të pajisjes sipas regjimit të punës;
- Plotëson librin e shërbimeve sipas rregullores së brendshme;
- Realizon montimin e pjesëve të ndryshme, sipas skemës dhe llojit të pajisjes;
- Zbaton teknikat e instalimit dhe fiksimit mekanik të pajisjes (instalim i lirë, i pandërprerë ose i integruar) sipas manualit;

- Kryen regjistrimet dhe shtrëngimet e ndryshme sipas manualit përkatës;
- Kryen rivendosjen e parametrave dhe regjimit normal të punës sipas manualit të përdorimit;
- Kryen provën e funksionalitetit të pajisjes pas procesit të mirëmbajtjes sipas standardit përkatës;
- Këshillon klientin duke shpjeguar operacionet bazë të përdorimit;
- Dokumenton procesin e mirëmbajtjeve në librin e shërbimeve sipas rregullores së brendshme;

E3-32-III-0013-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë sipërmarrjen dhe elementet e saj, si dhe lidhjen me veprimtarinë njerëzore;
2. Të shpjegojë funksionet e sipërmarrjes dhe organizimit të punës në biznes;
3. Të shpjegojë rëndësinë, mjetet, strategjinë e marketingut;
4. Të vlerësojë veçoritë e tregut dhe llojet e konsumatorëve në një sipërmarrje;
5. Të përshkruajë rëndësinë e bashkëpunimit me bankat, institucionet financiare dhe rolin e tyre në biznes;
6. Të shpjegojë konceptet bazë të legjislacionit dhe elementet përbërës të tij;
7. Të shpjegojë parimet bazë të kodit të punës, standardet e fushës së elektroteknikës;
8. Të listojë llogaritjet e thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës;
9. Të shpjegojë rëndësinë e llogaritjeve të materialeve dhe të grafikut të kohës së punës;
10. Të shpjegojë elementët edhe mënyrën e përgatitjes së faturave dhe ofertave;
11. Të listojë llojet e raportimeve;
12. Të vlerësojë rëndësinë e kontrollit të vazhdueshëm të çmimeve të tregut, të mjeteve, materialeve, pajisjeve dhe pjesëve të zëvendësimit bazuar në standardet përkatëse;
13. Të shpjegojë domosdoshmërinë e konsultimit me klientin mbi preventivin e hartuar;
14. Të përshkruajë elementët e llogaritjes së kostos së mjeteve, materialeve, pajisjeve, pjesëve të zëvendësimit dhe çmimit të një shërbimi;
15. Të përshkruajë llojet e faturave dhe mënyrat e plotësimit të tyre;
16. Të listojë mënyrat e blerjes së mjeteve, materialeve, pajisjeve dhe pjesëve të zëvendësimit;
17. Të përshkruajë elementet e llogaritjes përfundimtare për punimet/shërbimet e ofruara;
18. Të përshkruajë llojet e dokumenteve për shërbimet e kryera dhe mënyrën e përgatitjes;
19. Të listojë llojet e kontratave dhe kushtet e realizimit të tyre;
20. Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit të karrierës në përputhje me interesat, prirjet dhe cilësitë vetjake, mundësitë e tij/saj për karrierën duke marrë parasysh dhe prirjet e tregut të punës;
21. Të identifikojë rëndësinë e arsimit dhe trajnimit të vazhduar në zhvillimin e një sipërmarrje;
22. Të shpjegojë rëndësinë e informimit në kohë të bashkëpunëtorëve për njohuritë dhe aplikimin e teknikave të reja për zhvillimin e sipërmarrjes;
23. Të shpjegojë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes;

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë procedurat për kryerjen e detyrave administrative dhe tregtare;

2. Të zbatojë teknikat e marketingut;
3. Të kryejë trajnime të vazhduara bashkëkohore;

Kriteret e vlerësimit

1. Krijon një plan biznes të vogël në fushën e riparimeve të pajisjeve elektroshtëpiake sipas kërkesës;
2. Vlerëson veçoritë e tregut dhe llojet e konsumatorëve në një sipërmarrje sipas procedurës;
3. Përcakton mjetet dhe strategjitë e marketingut të biznesit, sipas parimeve të marketingut;
4. Bashkëpunon me bankat, institucionet financiare etj., sipas plan biznesit;
5. Zbaton kërkesat e legjislacionit fiskal dhe parimet bazë të kodit të punës;
6. Zbaton standardet dhe legjislacionin e fushës së elektroteknikës;
7. Kryen llogaritje të thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës sipas rregullit;
8. Merr informacion nga tregu për çmimet dhe cilësinë e mjeteve, materialeve, pajisjeve dhe pjesëve të zëvendësimit bazuar në standardet përkatëse;
9. Llogarit koston e mjeteve, materialeve, pajisjeve, pjesëve të zëvendësimit dhe çmimit të një shërbimi sipas rregullit;
10. Siguron në kohë mjetet, materialet, pajisjet dhe pjesët e zëvendësimit sipas kërkesës;
11. Përgatit preventivin dhe ofertën për punimet/shërbimin që do të kryejë sipas rregullit;
12. Konsultohet me klientin mbi preventivin e hartuar duke zbatuar rregullat e komunikimit;
13. Harton grafikun e punimeve dhe shërbimeve sipas planit;
14. Raporton në kohë për punën e kryer, sipas formateve të caktuara;
15. Përgatit faturën për punimet/shërbimet e ofruara sipas rregullit dhe legjislacionit në fuqi;
16. Asiston në hartimin e kushteve të kontratave sipas legjislacionit në fuqi;
17. Planifikon karrierën në përputhje me interesat, prirjet dhe cilësitë vetjake, si dhe prirjet e tregut të punës;
18. Vlerëson në mënyrë kritike nevojat për trajnim dhe zhvillim profesional;
19. Merr pjesë në trajnime sipas nevojave të zhvillimit të sipërmarrjes;
20. Informon në kohë bashkëpunëtorët për njohuritë dhe aplikimin e teknikave të reja për zhvillimin e sipërmarrjes;
21. Përdor Teknologjinë e Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes.

E3-31-III-0014-24 Komunikimi dhe etika profesionale

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë rëndësinë e komunikimit dhe teknikat përkatëse të tij;
2. Të përshkruajë rëndësinë e shkëmbimit të informacionit mbi problemet dhe të rejat e ditës;
3. Të përshkruajë parimet dhe domosdoshmërinë e punës në grup;
4. Të shpjegojë domosdoshmërinë e respektimit të hierarkisë;
5. Të përshkruajë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal me eprorët dhe kolegët;
6. Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale;
7. Të përshkruajë rëndësinë e kodit të etikës dhe zbatimit të tij;
8. Të shpjegojë domosdoshmërinë e shkëmbimit të udhëzimeve/procedurave me

- bashkëpunëtorët për realizimin e detyrës, duke pranuar mendimin kritik;
9. Të shpjegojë teknikat e zgjidhjes së problemeve dhe mosmarrëveshjeve;
 10. Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të TIK ⁴dhe rrjeteve sociale në komunikim;
 11. Të shpjegojë parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikim;

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë teknikat e komunikimit;
2. Të zbatojë kodin e etikës në komunikimin me të tjerët;
3. Të përdorë terminologji profesionale gjatë komunikimit;

Kriteret e vlerësimit

- Merr vazhdimisht informacione për problemet dhe të rejtat e ditës;
- Zbaton rregullat e organizatës në vendin e punës;
- Zbaton parimet e punës në grup;
- Bashkëpunon me eprorët dhe kolegët;
- Zbaton rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal;
- Zbaton parimet e etikës profesionale;
- Zgjidh ankesat dhe mosmarrëveshjet me klientët, duke zbatuar teknikat përkatëse;
- Përdor TIK në komunikimin me të tjerët;
- Përdor terminologjinë profesionale, sipas rregullave të komunikimit;
- Vepron/Komunikon në përputhje me parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.;
- Dëgjon me vëmendje për të qenë aktiv në një komunikim;

E3-05-III-0038-24 Sigurimi teknik dhe mbrojtja e mjedisit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë dhe dokumentacionin e detyrueshëm;
2. Të shpjegojë domosdoshmërinë e përdorimit të manualeve të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
3. Të listojë llojet e mjeteve të ndihmës së parë dhe përdorimi i tyre;
4. Të përshkruajë mënyrën e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
5. Të shpjegojë rolin e sinjalistikës në vendin e punës;
6. Të shpjegojë procedurat e evakuimit për raste emergjence;
7. Të shpjegojë përdorimin e pajisjeve të MZSH;
8. Të shpjegojë masat përkatëse gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike;
9. Të përshkruajë parimet bazë të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
10. Të përshkruajë procedurat e duhura për ndarjen e mbetjeve sipas llojit dhe depozitimin e tyre nga procesi i punës në përputhje me rregulloren e mjedisit;
11. Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit racional të lëndëve të para, pjesëve të këmbimit, mjeteve dhe pajisjeve të punës dhe të energjisë;
12. Të argumentojë rëndësinë e identifikimit dhe raportimit të mos funksionalitetit të mjeteve dhe pajisjeve;

⁴ Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit

13. Të shpjegojë rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
14. Të dallojë llojet e tabelave të sigurisë teknike;
15. Të interpretojë rëndësinë e zbatimit të rregullave të punës në lartësi;
16. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të pajisjeve mbrojtëse individuale dhe kolektive;
17. Të listojë efektet dëmtoese të gazit dhe mënyrat e mbrojtjes ndaj tij;
18. Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të rregullave të punës nën tension;
19. Të përshkruajë protokollet e duhura në raste të gjendjes së jashtëzakonshme.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë standardet e sigurimit teknik në punë;
2. Të zbatojë procedurat për mbrojtjen e shëndetit në punë;
3. Të zbatojë procedurat për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm;

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë dhe dokumentacionin e detyrueshëm;
- Përdor manualet e mjeteve dhe pajisjeve të punës për sigurinë;
- Përdor mjetet e ndihmës së parë, sipas manualeve;
- Jep ndihmën e parë në rast aksidenti, sipas procedurës përkatëse;
- Zbaton sinjalistikën në vendin e punës, sipas rregullores së brendshme;
- Zbaton procedurat e evakuimit në rast emergjence;
- Përdor pajisjet e MZSH, sipas manualit;
- Përdor me kujdes solucionet me përmbajtje kimike;
- Zbaton parimet bazë të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
- Zbaton procedurat e duhura për ndarjen e mbetjeve sipas llojit dhe depozitimin e tyre nga procesi i punës në përputhje me rregulloren e mjedisit;
- Përdor në mënyrë racionale lëndët e para, pjesët e këmbimit, mjetet dhe pajisjet e punës, si dhe energjinë;
- Raporton në kohë për mosfunksionimin e mjeteve dhe pajisjeve të sigurisë;
- Zbaton rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
- Zbaton rregullat e punës në lartësi;
- Përdor pajisjet mbrojtëse individuale dhe kolektive, sipas manualit;
- Zbaton rregullat e punës nën tension;
- Zbaton protokollet e duhura në raste të gjendjes së jashtëzakonshme;

Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:

Nr.	Njësi të nxëni	Peshat në %	Kodet
1	Planifikimi dhe organizimi i punës riparim pajisjesh elektroshtëpiake	5	E3-05-III-0031-24
2	Ndërtimi dhe funksionimi i pajisjeve elektroshtëpiake	15	E3-05-III-0032-24
3	Makina dhe transmise elektrike	10	E3-05-III-0033-24

4	Elektronikë e zbatuar	10	E3-05-III-0034-24
5	Diagnostikimi i defekteve	15	E3-05-III-0035-24
6	Riparime dhe zëvendësime në pajisje elektroshtëpiake	20	E3-05-III-0036-24
7	Mirëmbajtja e pajisjeve elektroshtëpiake	10	E3-05-III-0037-24
8	Sipërmarrje dhe edukim karriere	5	E3-32-III-0013-24
9	Komunikimi dhe etika profesionale	5	E3-31-III-0014-24
10	Sigurimi teknik dhe mbrojtja e mjedisit	5	E3-05-III-0038-24
		100%	

Modalitetet e vlerësimit

Me vlerësim kuptojmë procesin gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati të nxëni (RN), mbi bazën e kriterëve të caktuar.

Për vlerësimin mund të përdoren një shumëllojshmëri metodash standarde dhe inovatore.

Individi i nënshtrohet vlerësimit të vazhduar, përmbledhës dhe vlerësimit përfundimtar për kualifikimet formale që ofrohen në ofrues të akredituar.

Individi vlerësohet për shkallën e përvetësimit të kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën përkatëse dhe vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së RN për realizimin e tërësisë së proceseve duke mbajtur evidenca për qëllime dokumentimi.

Realizimi i pranueshëm do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të specifikuar.

Dhënia e rezultatit të vlerësimit bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Kompetencat e përgjithshme vlerësohen të integruara si pjesë e vlerësimit të njësive të të nxënit.

Individit i lind e drejta të certifikohet për njësitë të nxëni specifike, si një kualifikim i pjesshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Informacion shtesë

Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftohen nëpërmjet këtyre formave:

- a) ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;
- b) ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësim nxënies praktike;
- c) regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);
- d) njohjes të të nxënit të mëparshëm informal dhe joformal;
- e) njohjes të të nxënit të përftuar jashtë vendit;
- f) formave të tjera të përcaktuara me ligj

SHËNIM

Shpjegime të kodit të kualifikimit: **K-E3-III-23**

K - Kualifikim

E - Shkronja që identifikon drejtimin e kualifikimit

3 - Numri që identifikon profilin e kualifikimit përkatës

III - Shifra që identifikon nivelin sipas KSHK

23 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar kualifikimi

Shpjegime të kodit të njësisë së të nxënit: **E3-05-III-0031-24**

E3 - Shkronja që identifikon drejtimin dhe profilin e kualifikimit

05 - Numri që identifikon orientimin e Njësisë së të Nxënit

III - Shifra që tregon nivelin e Njësisë së të Nxënit në strukturën e KSHK

0031 - Numri rritës progresiv që tregon gjendjen e Njësive të të Nxënit në ditën e hartimit përkatës

24 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar Njësia e të Nxënit